


AKTI I THEMELIMIT



I

SHOQERISE TREGTARE

“LALI” SHPK

Neni 1

Mes personave te meposhtem :

1. Dashnor Kaleshi, shtetas shqiptar, i biri Xhelal-it dhe i Melos, i lindur me 05.07.1971 ne Konispol dhe banues ne Konispol;
 2. Hysen Kaleshi, shtetas shqiptar, i biri Xhelal-it dhe i Melos, i lindur me 17.02.1976 ne Konispol dhe banues ne Konispol
- themelohet nje shoqeri tregtare me perjegjesi te kufizuar me emertimin : “LALI” SHPK.

Neni 2

Shoqeria “LALI” SHPK ka per objekt te veprimtarise se saj:

Import-eksport i mallrave industriale, trikotazhe, tekstile, veshimbathje,
tregti me pakice i karburanteve, bar-bufe e restorant, hoteleri,
agjensi turistike, spedicionere, doganore, hapje linjash prodhimi.
Ajo mund te kryeje cdo operacion tjeter tregtar, industrial e financiar, qe do te
konsiderohet prej Asamblese se ortakeve, i nevojshem dhe i dobishem per
arritjen e objektivit te shoquerise.

Neni 3

Selia e shoquerise “LALI” SHPK eshte ne Konispol

Neni 4

Kapitali themeltar i shoquerise “LALI” SHPK eshte 100.000 leke
(njeqindmije leke) dhe ndahet ne kuota te barabarta prej 1.000 leke (njemije
leke) secila.

Ky kapital merret persiper e nenshkruhet nga ortaket themelues
perkatesisht:

Dashnor Kaleshi:

Hysen Kaleshi:



1.Dashnor Kaleshi	50 kuota	ose	50.000lek
2.Hysen Kaleshi	50 kuota	ose	50.000lek
TOTALI	100 KUOTA		100.000LEK

Neni 5

Shoqeria deklarohet e krijuar ne perputhje te plete me normat e ketij akti dhe ato te percaktuara ne statutin e shoqerise, si dhe te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", dhe ligjit nr. 7667, date 28.10.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

Neni 6

Kohezgjatja e shoqerise tregtare "LALI" SHPK eshte e pakufizuar dhe te pakten 10 vjet. Ky afat mund te ndryshoje me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 7

Shoqeria administrohet nga dy ortaket e saj qe jane te dy administratore.

Neni 8

Viti i pare finanziar do te mbyllte me 31 dhjetor.

Neni 9

Ky akt perpilohet ne kater kopje per:

- Gjykaten e rrethit te Tiranes per te bere veprimet ne Regjistrin Tregtar dhe njojen si person juridik te kesaj Shoqerie
- Zyren e tatimeve per marrjen e certifikates se regjistrimit ne organin tatimor
- Dhomen e Noterise
- nje kopje mbetet si pjese e dokumentacionit te themelimit te shoqerise tregtare "LALI" SHPK.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE TREGTARE

"LALI" SHPK

Dashnor Kaleshi


Hysen Kaleshi

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE**

Nr. 2459 Rep
Nr. 167 Kol

VERTETIM

Sot, me date 1/6/2000 u paraqiten personalisht para meje Noteres, personat: Dashnor Kaleshi, shtetas shqiptar, i biri Xhelal-it dhe i Melos, i lindur me 05.07.1971 ne Konispol dhe banues ne Konispol me leternjoftim Nr 268873 dhe Hysen Kaleshi, shtetas shqiptar, i biri Xhelal-it dhe i Melos, i lindur me 17.02.1976 ne Konispol dhe banues ne Konispol, me pasaporte 00717558, te panjohur prej meje, per identitetin e te cileve, une Noteria, u sigurova nga pasaportat e tyre personale, te cilet deklaruan se akti i mesiperme eshte hartuar sipas vullnetit te tyre te lire e te plote dhe nenshruan rregullisht ne prezencen time.





STATUTI



I

SHOQERISE TREGTARE

“LALI” SHPK

EMERTIMI Neni 1

Themelohet shoqeria tregtare me perjegjesi te kufizuar me emertimin “LALI” SHPK.

OBJEKTI Neni 2

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj:

Import-eksport i mallrave industriale, trikotazhe, tekstile, veshmbathje, tregti me pakice i karburanteve, bar-bufe e restorant, hoteleri, agjensi turistike, spacionere, doganore, hapje linjash prodhimi. Ajo mund te kryeje te gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare, mobiliare e imobiliare, qe do te konsiderohen nga asamblea e ortakeve te nevojshme e te dobishme per realizimin e objektit te shoqerise.

SELIA Neni 3

Shoqeria “LALI” SHPK e ka seline ne Konispol

KOHEZGJATJA Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise tregtare “LALI” SHPK eshte e pakufizuar dhe te pakten 10 vjet. Ky afat mund te ndryshoje me vendim te asamblese se ortakeve.

Dashur Esposhti
Gjergj

Hysen Hoxha
Pefkhi



KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise tregtare "LALI" SHPK eshte 100.000 leke (njeqimmi leke) dhe ndahet ne pjesa sipas nenit 4 te Aktit te Themelimit te shoqerise.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar nenshruhen ne teresine e tyre e shlyhen krejtesisht nga ortaket, dhe fondet depozitohen prane bankes Tirana Bank.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane lirisht te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve e pasardhesve.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'iu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjesa ne Shoqeri, vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqsojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.

Projekti i transferimit i njoftohet Shoqerise dhe secilit prej ortakeve.

Ne rast se Shoqeria nuk e ka bere te ditur vendimin e saj, brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit, miratimi i transferimit konsiderohet i dhene.

Ne rast se Shoqeria refuzon te jape miratimin e transferimit, ortaket, brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi, duhet te blejne apo te lejojne blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar.

Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me nje akt notarial.

ASAMBLEA

Neni 6

Asamblea perfaqson universalitetin e ortakeve dhe vendimet e saj te marra ne perputhje me ligjin dhe kete statut jane te detyrueshme per te gjithe ortaket.

Mbledhjet e asamblese thirren nga administratori te pakten 15 dite perpara mbledhjes se asamblese. Ne njoftim duhet te tregohen dita, vendi, ora e mbledhjes si dhe rendi i dites.

Mbledhjet e asemblese qe nuk jane thirrur si me siper, jane te vlefshme ne rast se te gjithe ortaket jane te pranishem ose te perfaqsuar.

Nje ose disa ortake qe perfaqsojne te pakten 10% te pjeseve te kapitalit themeltar, mund te kerkojne mbledhjen e asamblese.

Ajo mund te mblidhet edhe jashte selise se saj.

Mbledhjet e asamblese kryhesohen nga Administratori.

Cdo ortak ka nje vote per cdo nje mijë leke.

Cdo ortak mund te perfaqsohet, me prokure, nga nje ortak ose person tjeter.

Dodhnoe Lek Pashli
Zyrtar

Hysen Haleshi
Zyrtar

*MINISTERI
TIRAKE*

Ne mbledhjet e Asamblese ose ne konsultimet me shkrim vendimet merren nga nje ose disa ortake qe perfaqsojne me shume se 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar. Ne rast se nuk sigurohet kjo shumice, ortaket thirren ose konsultohen per here te dyte dhe vendimet merren me shumicen e votave te dhena pavaresisht nga perqindja e kapitalit qe ato perfaqsojne.

Per ceshtjet e shqyrtuara dhe vendimet e asamblese mbahet procesverbal qe firmoset nga Administratori.

Ne rastet e parashikuar me ligj, procesverbali redaktohet nga nje noter i zgjedhur nga Administratori.

ADMINISTRIMI

Neni 7

Shoqeria administrohet nga dy ortaket qe jane te dy administratore.

Administratori ka te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoquerise, dhe gezon te drejten per te kryer te gjitha veprimet qe i konsideron te pershatshme per zbatimin dhe arritjen e objektivave te shoquerise, me perjashtim te atyre qe ligji ua jep shprehimi i ortakeve.

Administratori perfaqson shoquerine kundrejt te treteve dhe ne gjykim, me te drejten per te iniciuar veprimet gjyqesore e administrative ne cdo shkalle juridiksiioni dhe te emeroje per kete qellim avokate.

Administratori nuk mund te ushtroje nje aktivitet konkurrues per llogari te vet ose te te treteve, me perjashtim kur eshte i autorizuar nga asamblea.

Administratori duhet te zbatoje detyrat qe i ngarkon ligji, akti i themelimit, statuti, dhe eshte individualisht ose solidarisht, sipas rastit, persegjegjes ndaj shoquerise ose te treteve per demet e shkaktuara nga mosperm bushja e ketyre detyrave, si dhe per shkelje te ligjit, per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoquerise.

Administratori shkarkohet me vendim te ortakeve qe perfaqsojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar.

Pervec kesaj, administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkeset te edonjerit prej ortakeve.

Emertimi i shoquerise, kapitali dhe emri i Administratorit te saj duhet te figurojne ne te gjitha aktet ose dokumentet e nxjerra nga shoqeria dhe qe u drejtohen te treteve.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 8

Vitet financiare mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti.

Ne fund te cdo viti finanziar Administratori harton ne perputhje me ligjin bilancin e shoquerise, me llogarite fitime e humbje, dhe pergaat raportin me shkrim per administrimin.

Jasmin Kaledhi

Gjy

Hysen Kaledhi

Gjy

Raporti i administrimit, i ventaret dhe llogarite vjetore te hartuara nga Administratoret, i nensstrohen miratimit te Asamblese se Ortakeve brenda nje afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

Cdo ortak mund te kerkoste te dhena per ecurine e veprimtarise se shoqerise e te konsultoje librat e shoqerise, per tre vitet e fundit financiare.

Fitimi neto, pasi te jete lene menjane nje shume me vlore te pakten 5% e tij, e cila destinohet per formimin e nje foni rezerve te quajtur "rezerve e domosdoshme", pavec kur asamblea vendos per rezerva te jashtezakonshme apo per ndonje destinacion tjeter, ose vendos qe te kalojne te gjitha ose nje pjese per vitet financiar te ardheshem.

Pagimi i dividenteve behet ne vendin e caktuar nga Administratori brenda nje afati qe caktohet cdo vit nga ky i fundit.

MARREDHENIET E PUNES

Neni 9

Marredheniet e punes ne Shoqerine Tregtare "LALI" SHPK rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtje qe nuk rregullohen me kontrate pune zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Shoqeria merr persiper qe te respektoje rregullat e ligjet ne fuqi te punesimit dhe te sigurimeve shoqerore per te gjithe te punesuarit ne Shoqeri, ndersa keta te fundit jane te detyruar te pranojne kete Statut te Shoqerise.

Te punesuarit ne Shoqeri pergiqjen sipas ligjit dhe sipas Statutit per moszbatin min e detyrave te caktuara, si dhe per demet qe ata i shkaktojne Shoqerise. Ata mbajne perjegjesi penale dhe administrative per moszbatin min e detyrave te tyre.

Mosmarreveshjet e te punesuareve me Shoqerine zgjidhen nga gjykata shqiptare. Kur pala ankuese eshte person i huaj, mosmarreveshja zgjidhet nga organi i percaktuar ne kontraten e punes.

SHPERBERJA

Neni 10

Kur, ne cdo moment e per cfardolloj shkaku arrihet ne shperberjen e shoqerise, asamblea cakton modalitetet e likuidimit dhe emeron nje ose disa likujdatore, me pelqimin e shumices per nga kapitali te ortakeve, duke u percaktuar kompetencat.

Ne rast likuidimi te Shoqerise, emertimi i saj do te pasohet nga shenimi "Shoqeri ne likuidim e siper".

Ndarja e kapitaleve te veta, qe mbeten pas pagimit te kreditoreve dhe te pjeseve te kapitalit themeltar, behet ndermjet ortakeve, ne perpjestim te njeje me kontributin e tyre ne kapitalin themeltar.

Ortaket thirren ne fund te procesit te likuidimit qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullueshmerise per administrimin

Jashnor Koleksi
Gjyqtar

Hyrcan Hoxha
Gjyqtar

nga ana e likuiduesit dhe per heqjen e mandatit te tij si likuidues si dhe per te evidencuar mbylljen e likuidimit.

Mbasi behet njoftimi i mbylljes se likujdimit dhe kryhen formalitetet e nevojshme te likuidimit, Shoqeria c'registrohet nga Regjistri Tregtar i Gjykates se rrethit te Tiranes.

SHNDERRIMI I SHOQUERISE

Neni 11

Shnderrimi i shoquerise ne shoperi kolektive ose komandite behet me miratimin unanim te ortakeve.

Shnderrimi ne shoperi anonime behet me shumicen e votave te ortakeve qe perfaqsojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 12

Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut i referohet plotesimeve nga Asambleja e Ortakeve te Shoquerise, si dhe dispozitave te legjislacionit shqiptar.

Neni 13


Ky akt perpilohet ne kater kopje per:

- Gjykaten e rrethit te Tiranes per te bere veprimet ne Regjistrin Tregtar dhe njojen si person juridik te kesa Shoqerie
- Zyren e tatimeve per marrjen e certifikates se regjistrimit ne organin tatimor.
- Dhomen e Noterise
- nje kopje mbetet si pjese e dokumentacionit te themelimit te shoquerise tregtare "LALI" SHPK.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQUERISE TREGTARE

"LALI" SHPK

Dashnor Kaleshi



Hysen Kaleshi

